

L I G J¹
Nr. 7975, datë 26.7.1995

PËR BARNAT NARKOTIKË DHE LËNDËT PSIKOTROPE

(ndryshuar me Ligjin nr. 9271/2004, datë 9.9.2004; me Ligjin nr. 9559/2006, datë 8.6.2006; me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; me Ligjin nr. 46/2013, datë 14.2.2013; me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat e prodhimit, fabrikimit, importimit, eksportimit, tregtimit, përdorimit, kontrollit dhe ruajtjes së barnave narkotike dhe lëndëve psikotrope.

Neni 2

Në kuptim të këtij ligji, barna narkotike dhe lëndë psikotrope me prejardhje natyrore ose sintetike janë një grup i vecantë lëndësh, përdorimi abuziv i të cilave dëmton shëndetin dhe krijon varësi të përdoruesit nga këto lëndë.

KREU II
KLASIFIKIMI I BARNAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

Neni 3

Lëndët dhe përgatesat e përfshira në këtë ligj janë klasifikuar në 3 tabela, I, II dhe III sipas masave të kontrollit që ushtrohen për këto lëndë.

Neni 4

(ndryshuar dhe shtuar paragraf me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Të gjitha bimët dhe lëndët e klasifikuara si barna narkotike ose si lëndë psikotrope nga konventat ndërkombëtare ose akte të tjera në zbatim të këtyre konventave; përgatesat e tyre, si

¹ Ligji 7975/1995, datë 26.7.1995 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 25.8.1995

Ligji nr. 9271/2004, datë 9.9.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 7.10.2004

Ligji nr. 9559/2006, datë 8.6.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 6.7.2006

Ligji nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.86, datë 12.6.2009

Ligji nr. 46/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12.3.2013.

Ligji nr. 99/2023, datë 14.12.2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 5.1.2024.

dhe gjithë bimët dhe lëndët e tjera të rrezikshme për shëndetin publik, për shkak të efekteve të dëmshme që rezultojnë nga keqpërdorimi i tyre, janë përfshirë në tri tabela. Klasifikimi i tyre është bërë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë për shëndetin që mund të sjellë keqpërdorimi i tyre dhe faktit nëse ato kanë ose jo përdorim mjekësor.

Tabela I: bimë dhe lëndë me rrezikshmëri të lartë që nuk përdoren në mjekësi.

Tabela II: bimë dhe lëndë me rrezikshmëri të lartë që përdoren në mjekësi.

Tabela III: bimë dhe lëndë të rrezikshme që përdoren në mjekësi.

Tabela II ndahet në dy grupe, A dhe B, sipas masave të kontrollit që zbatohen për to. Tabela III ndahet në tri grupe: A, B dhe C, sipas masave të kontrollit që zbatohen për to.

Përfshirja nga rregulli për “Tabela I” bëhet për bimën e *cannabis*-it dhe nënproduktet e saj për të cilat zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, sipas legjislacionit përkatës për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës, si dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.

Neni 5

Bimët janë shënuar me emrin e tyre shqip dhe latinisht, ndërsa lëndët janë shënuar me emrin ndërkombëtar në gjuhën shqipe ose në mungesë të tij, me emrin shkencor.

Neni 6

Përzierjet e ngurta ose tretësirat që përmbajnë një ose më shumë lëndë që kontrollohen nga ky ligj, si dhe lëndët psikotrope të dozuar, i nënshtrohen të njëjtit kontroll si dhe lëndët përbërëse të tyre. Përgatesat që përmbajnë dy ose më shumë lëndë, të cilat u nënshtrohen regjimeve të ndryshme kontrolli, do të trajtohen sipas regjimit të lëndës më të kontrolluar.

Neni 7

Tabelat janë përpiluar sipas Konventës Unike për Barnat Narkotikë të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971.

Neni 8

(*ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023*)

Përgatesat, që përmbajnë një nga lëndët e tabelave II ose III, por që paraqet rrezik abuzimi të papërfillshëm, dhe kur lënda nuk mund të përftohet me metoda të thjeshta në sasi që krijojnë rrezik abuzimi, mund të përjashtohen nga disa masa kontrolli të parashikuara në këtë ligj me urdhër të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë. Në këtë urdhër përcaktohen qartë masat e kontrollit nga të cilat përjashtohen këto përgatesa.

KREU III

NDALIMI I KULTIVIMIT TË BIMËVE QË PËRMBAJNË LËNDË NARKOTIKE

Neni 9

(*ndryshuar me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023*)

Në Republikën e Shqipërisë ndalohen kultivimi i hashashit (*Papaver somniferum*) për prodhimin e opiumit dhe të kashtës, kultivimi i bimës së kokës (*Erythroxylon coca*) për prodhimin e alkaloideve e të lëndëve aromatike, si dhe kultivimi i të gjitha llojeve dhe varieteteve të bimëve të gjinisë *cannabis* për prodhimin e kanabisit, të rrëshirës dhe vajit.

Lejohet përjashtimisht përpunimi i bimës së *cannabis*-it dhe prodhimi i nënprodukteve të saj

vetëm për qëllime mjekësore dhe industriale, sipas legjislacionit të posaçëm të miratuar për këtë qëllim.

Neni 10

Pronari ose përdoruesi i tokës bujqësore e jobujqësore, si dhe të punësuarit pranë tyre, janë të detyruar të shkatërrojnë bimët e përmendura në nenin 9, kur ato rriten në mënyrë spontane në tokën e papunuar ose kanë qënë kultivuar në mënyrë të paligjshme nga paraardhësit e tyre.

Neni 10/1

(*shtuar me Ligjin nr. 9559/2006, datë 8.6.2006*)

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, specialistët e Policisë së Rendit dhe të Policisë Kriminale në zonë, brenda juridiksionit të tyre administrativ, në bashkëpunim edhe me strukturën përkatëse të luftës kundër drogës në drejtorinë e policisë të qarkut, organizojnë punën për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, zbulimin e sipërfaqeve të kultivuara dhe identifikimin e personave përgjegjës.

2. Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore, specialistët e Policisë së Rendit dhe të Policisë Kriminale në zonë, për çdo rast të vërejtjes apo marrjes dijeni për kultivimin e bimëve narkotike në zonën që mbulojnë, janë të detyruar të raportojnë menjëherë me shkrim në strukturën përkatëse të luftës kundër drogës në drejtorinë e policisë të qarkut.

3. Kur personat e mësipërm veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, sipas rastit, janë subjekte të veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 300 dhe 301 të Kodit Penal.

KREU IV

NDALIMI I VEPRIMTARIVE QË LIDHEN MË LËNDËT DHE PËRGATESAT E TABELËS I

Neni 11

(*shtuar paragraf me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023*)

Ndalohet prodhimi, fabrikimi, tregtimi dhe shpërndarja me shumicë dhe pakicë, transportimi, mbajtja, furnizimi, dhënia me para ose falas, blerja, përdorimi, importimi, eksportimi, kalimi tranzit i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përfshira në tabelën I në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përfshirja nga parashikimet e paragrafit të parë të këtij neni bëhet për bimën e *cannabis*-it dhe nënproduktet e saj për të cilat zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, sipas legjislacionit përkatës për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it, dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.

KREU V

RREGULLIMI I VEPRIMTARIVE QË LIDHEN ME BIMËT, LËNDËT DHE PËRGATESAT E TABELAVE II DHE III

Neni 12

Lëndët e përfshira në tabelat II dhe III dhe përgatesat e tyre i nënshtrohen dispozitave të

zbatueshme për të gjitha lëndët dhe përgatesat e destinuara për përdorim mjekësor e veterinar, siç përcaktohet në ligjin “Për barnat”, në masën që këto të fundit janë në pajtim me këtë ligj.

Neni 13

(ndryshuar me Ligjin nr. 9271/2004, datë 9.9.2004; ndryshuar dhe shfuqizuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Prodhimi, fabrikimi, tregtimi ndërkombëtar, shitja me shumicë dhe pakicë, përdorimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përcaktuara në tabelën II, u lejohe vetëm personave të pajisur me autorizim për këto veprimtari.

Autorizimi nevojitet edhe për prodhimin, fabrikimin dhe tregtimin ndërkombëtar të bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përcaktuara në tabelën III.

Për objektet dhe ndërtesat ku do të kryhen veprimtaritë e mësipërme kërkohet autorizim i posaçëm.

A. AUTORIZIM PËR KRYERJE VEPRIMTARIE.

Neni 14

(ndryshuar me Ligjin nr. 9271/2004, datë 9.9.2004; ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në nenin 13, miratohet nga Komisioni Ndërmintor i përbërë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Komisioni Ndërmintor përcakton kriteret për pajisjen me autorizim.

Neni 15

(Shfuqizuar me Ligjin nr. 9271/2004, datë 9.9.2004)

I. KUSHTET E DHËNIES SË AUTORIZIMIT

Neni 16

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi mund të jepet vetëm në qoftë se përdorimi i lëndëve dhe përgatesave të tyre kufizohet për qëllime mjekësore dhe shkencore.

Përdorimi i lëndëve të tabelave II dhe III në industri për qëllime të tjera mund të autorizohet vetëm në rastet kur kërkuesi tregon me prova se është në gjendje t'i sigurojë këto lëndë nga vjedhja, keqpërdorimi dhe ndryshimi i destinacionit, si dhe të sigurojë se produktet e fabrikuara nuk do të kenë efekte të dëmshme, nuk do të keqpërdoren dhe se lëndët nën kontroll që janë në përbërjen e tyre nuk mund të ripërftohen lehtësisht.

Dispozitat e këtij ligji, përveç atyre që lidhen me fabrikimin, nuk do të zbatohen për produktet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni.

Neni 17

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009 dhe me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Të drejtën për t'u pajisur me autorizim për ushtrim veprimtarie e kanë vetëm farmacistët ose personat juridikë nën drejtimin ose administrimin e të cilëve bën pjesë edhe një farmacist.

Kur ndërmarrja ka më shumë se një degë, drejtimi teknik i secilës prej tyre duhet të kryhet të paktën nga një farmacist. Në të gjitha rastet farmacisti është personalisht përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe kushteve të parashikuara në autorizim.

Neni 18

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Dhënia e autorizimit kushtëzohet nga kualifikimi profesional i kërkuesit dhe plotësimi i kushteve të tjera të parashikuara në rregulloren përkatëse.

II. KËRKESA PËR AUTORIZIM

1.TË DHËNAT QË JEPEN NË ÇDO KËRKESË

Neni 19

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

a) Në kërkesën për autorizim që paraqitet nga një person fizik shënohet emri dhe adresa e tij, si dhe shoqërohet me një vërtetim të shoqatës së farmacistëve ku është anëtarësuar.

b) Në kërkesën për autorizim që paraqitet nga një person juridik shënohet emri (emërtimi) i personit juridik, emri dhe adresa e drejtuesit të tij, si dhe emri dhe adresa e personit përgjegjës për zbatimin e kushteve të autorizimit shoqëruar me vërtetimin e shoqatës së farmacistëve ku bën pjesë.

Në të gjitha rastet në kërkesë shënohen emrat dhe adresat e të gjithë personave që do të marrin pjesë në kryerjen e veprimtarive, si dhe lloji i proceseve për të cilat kërkohet autorizimi.

2. TË DHËNA PLOTËSUESE QË DUHET TË JEPEN NË ÇDO KËRKESË SIPAS LLOJIT TË VEPRIMTARISË QË KËRKOHET TË KRYHET

Neni 20

a) Kur kërkesa është formuluar për fabrikim, në të duhet të shënohen emërtimi dhe sasia e lëndëve të para që do të përdoren për fabrikim, lëndët dhe përgatesat që do të fabrikohen, procedurat e fabrikimit që do të përdoren, sasitë e lëndëve dhe përgatesave që parashikohen të fabrikohen së bashku me përbërjen dhe destinacionin e tyre.

b) Kur kërkesa është formuluar për përdorim të lëndëve në industri për qëllime të tjera jo mjekësore e shkencore, specifikohen procedurat e denatyrimit ose të tjera që do të përdoren për të siguruar që produktet e fabrikuara nuk mund të keqpërdoren ose të japin efekte të dëmshme, si dhe që lënda nën kontroll nuk mund të përftohet lehtësisht.

c) Kur kërkesa është formuluar për shitje me shumicë, në të shënohet emri i lëndëve dhe përgatesave që do të shiten.

ç) Kur kërkesa është formuluar për eksport dhe/ose import, në të shënohet natyra e veprimtarive të parashikuara, vendet me të cilat do të kryhen, si dhe emri i lëndëve dhe përgatesave objekt i këtyre veprimtarive.

3. PËRMBAJTJA DHE RËNDËSIA E AUTORIZIMIT

Neni 21

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Në autorizim, përveç të dhënave të nenit 19, përcaktohet edhe afati i vlefshmërisë së saj.

Në të tregohen lëndët dhe përgatesat që lidhen me veprimtarinë e autorizuar, sasitë e tyre, lloji i kontabilitetit që do të mbahet, si dhe gjithë kushtet e detyrimit e tjera që duhet të përmbushë mbajtësi i autorizimit.

Neni 22

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi është vetjake dhe e patjetërsueshme.

Autorizimi mbulon të gjitha proceset që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e autorizuar.

Neni 23

(ndryshuar me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Çdo ndryshim i objektit, i emrit të personit juridik, i natyrës së veprimtarisë të tij, çdo ndryshim i bimëve, lëndëve dhe përgatitësve të tabelave II e III, që përfshihen në veprimtarinë, për të cilën subjekti është pajisur me autorizim, njoftohet pranë Ministrisë së Shëndetësisë, për të reflektuar ndryshimet në autorizimin përkatës.

Neni 24

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Urdhri i ministrit përgjegjës për Shëndetësinë për të ndaluar një ose më shumë procese që lidhen me bimët, lëndët ose përgatesat e tabelave II dhe III, e bën të pavlefshëm autorizimin e mëparshëm lidhur me këto procese.

Neni 25

Ndërmarrjet private të autorizuar dhe ndërmarrjet shtetërore të caktuara posaçërisht, kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë blerjen, transferimin ose shpërndarjen e bimëve, lëndëve ose përgatesave të tabelave II dhe III vetëm me personat fizikë ose juridikë të autorizuar.

Neni 26

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Ndërmarrja private e autorizuar mund t'i transferohet vetëm një personi fizik ose juridik të pajisur me autorizim për të njëjtat veprimtari që kryhen me të njëjtat bimë, lëndë dhe përgatesa.

Në rast të vdekjes ose të pushimit të veprimtarisë së mbajtësit të autorizimit, ministri përgjegjës për Shëndetësinë mund të autorizojë, brenda 30 ditësh, vazhdimësinë e veprimtarisë nën përgjegjësinë e një zëvendësuesi që plotëson kushtet dhe që merr përsipër detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe në autorizim.

4. PEZULLIMI DHE ANULIMI I AUTORIZIMIT

Neni 27

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Autorizimi anulohet në rast se konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji, parregullsi

në ushtrimin e veprimtarisë së autorizuar, sidomos shkelje të detyrimeve të parashikuara në autorizim, pakujdesi të personelit përgjegjës ose në rast se kërkesa për autorizim përmban deklarime të pasakta.

Në rastet kur shkeljet e konstatuara nuk janë të rënda, ministri përgjegjës për Shëndetësinë mund të pezullojë autorizimin për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj.

Autorizimi mund t'i refuzohet ose/dhe t'i anulohet çdo personi që ka qënë i dënuar për trafik ose përdorim të paligjshëm të lëndëve dhe përgatesave objekt i këtij ligji. Autorizimi pezullohet deri në marrjen e vendimit të formës së prerë në rastet kur mbajtësi i autorizimit është në proces hetimi ose gjykimi për një nga këto shkelje.

Neni 28

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anulimin e autorizimit merret pasi pala e interesuar thirret për të dhënë shpjegime.

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anulimin e autorizimit duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet palës së interesuar. Vendimi i komunikohet organeve kompetente për të kontrolluar zbatimin e tij. Këto organe kanë listat e personave fizikë e juridikë të pajisur me autorizim.

Neni 29

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Vendimi i anulimit ose pezullimit të autorizimit merret pavarësisht nga sanksionet administrative e penale që mund të zbatohen.

Neni 30

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 9271/2004, datë 9.9.2004; ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Në rast se ndërmarrja e pushon veprimtarinë ose autorizimi anulohet apo i kalon afati, ministrit përgjegjës për Shëndetësinë i dorëzohen dokumentacioni i porosive dhe regjistrat. Në zbatim të vendimeve gjyqësore, Ministria e Shëndetësisë merr masat e nevojshme për sigurimin e materialeve që gjenden në to.

B. AUTORIZIMI I POSAÇËM PËR PËRDORIMIN E OBJEKTEVE DHE NDËRTESAVE

Neni 31

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi i posaçëm për të përdorur të gjithën ose një pjesë të objekteve dhe ndërtesave që disponon një person juridik privat i autorizuar ose një ndërmarrje shtetërore e përcaktuar posaçërisht për prodhimin, fabrikimin, shitjen me shumicë, tregtinë ndërkombëtare dhe përdorimin e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III jepet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike .

Autorizimi i posaçëm jepet ose refuzohet brenda 90 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 32

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi i posaçëm jepet vetëm për objekte dhe ndërtesa të përdorura nga persona

fizikë e juridikë të pajisur me autorizim siç përcaktohet në nenin 14, ose nga ndërmarrje shtetërore të caktuara posaçërisht për të kryer veprimtari me bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelave II dhe III.

Neni 33

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Në kërkesën për autorizim të posaçëm, saktësohet vendndodhja e çdo objekti e ndërtese që do të përdoret tërësisht apo pjesërisht, si dhe e drejta për shfrytëzimin e tyre. Kërkesa shoqërohet edhe me përshkrimin dhe planimetrinë e hollësishme të objektit apo ndërtesës.

Në kërkesë paraqiten masat e sigurimit që do të ndërmerren për të realizuar kontrollin dhe për të parandaluar vjedhjen dhe grabitjen e bimëve, lëndëve, përgatesave dhe produkteve të fabrikuar.

Në kërkesë shënohet emri dhe adresa e personit fizik a juridik që është ngarkuar posaçërisht me zbatimin e masave të sigurimit të parashikuara.

Neni 34

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Lëshimi i autorizimit të posaçëm bëhet pasi verifikohet plotësimi i kushteve dhe masave të sigurimit të përcaktuara për objektet dhe ndërtesat në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 35

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Çdo objekt dhe çdo ndërtesë duhet të pajisen me autorizim të posaçëm të veçantë. Megjithatë, i njëjti dokument mund të lejojë përdorimin e disa objekteve dhe ndërtesave.

Neni 36

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Në autorizimin e posaçëm përcaktohet afati i vlefshmërisë së saj. Në të cilësohen çdo objekt dhe çdo ndërtesë, ose pjesë të tyre, përdorimi i të cilave autorizohet.

Në autorizimin e posaçëm precizohen masat e sigurimit që do të zbatohen në çdo rast, si dhe personi fizik a juridik që përgjigjet për zbatimin e tyre.

Neni 37

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Krijimi i degëve, përdorimi i pjesëve të reja ose objekteve dhe ndërtesave të reja, si dhe çdo ndryshim në masat e sigurimit të specifikuar në autorizimin e posaçëm, bëhet vetëm me autorizim paraprak të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Vendimi për lejimin ose refuzimin jepet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 38

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi i posaçëm mund të anulohet për gjithë objektet dhe ndërtesat, ose për disa

prej tyre në rastet e mosrespektimit të detyrimeve të specifikuara në autorizimin e posaçëm, ose në rast se deklarimet e bëra në kërkesën për autorizim të posaçëm janë të pasakta.

Në rastet kur shkeljet e konstatuara nuk janë të rënda, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike mund të pezullojë autorizimin e posaçëm për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj.

Neni 39

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anulimin e autorizimit të posaçëm merret pasi pala e interesuar thirret për të dhënë shpjegime.

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anulimin e autorizimit të posaçëm duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet palës së interesuar. Vendimi i komunikohet organeve kompetente për të kontrolluar zbatimin e tij. Këto organe kanë listat e ndërtesave dhe objekteve private e shtetërore të pajisur me autorizim të posaçëm.

Neni 40

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Ndërpreja e vlefshmërisë së autorizimit, për arsye që lidhen me kryerjen e veprimtarive të autorizuar për të cilat përdoren objektet dhe ndërtesat, e bën të pavlefshëm autorizimin e posaçëm të dhënë për këto të fundit.

KREU VI

PRODHIMI, FABRIKIMI, SHITJA OSE SHPËRNDARJA ME SHUMICË, TREGTIA NDËRKOMBËTARE DHE PËRDORIMI I LËNDËVE DHE PËRGATESAVE TË TABELAVE II DHE III

A. KUFIZIMI I SASISË SË LËNDËVE

Neni 41

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Ministri përgjegjës për Shëndetësinë cakton çdo vit sasi të maksimale të lëndëve dhe përgatesave të ndryshme që çdo person juridik privat dhe shtetëror mund të mbajë, duke pasur parasysh funksionimin normal të tyre dhe konjunkturën e tregut. Këto kufizime mund të ndryshohen gjatë vitit nëse shihet e nevojshme.

B. KUFIZIMI I FABRIKIMIT

Neni 42

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Ministri përgjegjës për Shëndetësinë cakton çdo vit sasi të maksimale të lëndëve dhe përgatesave të ndryshme që çdo person juridik privat dhe shtetëror mund të fabrikojë duke pasur parasysh konjunkturën e tregut. Këto kufizime mund të ndryshohen gjatë vitit nëse shihet e nevojshme.

C. TREGTIA NDËRKOMBËTARE

Neni 43

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Vetëm personat juridikë privatë të pajisur me autorizim për kryerje veprimtarie sipas nenit 14 dhe ndërmarrjet shtetërore të caktuara posaçërisht, që përdorin objekte dhe ndërtesa të pajisura me autorizim të posaçëm sipas nenit 31, mund të kryejnë tregtinë ndërkombëtare të bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III.

1. EKSPORTI DHE IMPORTI

Neni 44

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009 ; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Eksportimi dhe importimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III bëhet vetëm me autorizim import-eksporti të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë, sipas modelit të hartuar nga Komisioni i Barnave Narkotikë i Këshillit Ekonomik e Social të Kombeve të Bashkuara.

Ky autorizim import-eksporti është i patjetërsueshëm.

Neni 45

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Në kërkesën për autorizim import-eksporti shënohet natyra e procesit që do të kryhet, emrat dhe adresat e importuesit/eksportuesit, emri i marrësit të ngarkesës në qoftë se njihet, emrin e përbashkët ndërkombëtar të çdo lënde dhe në rast se mungon një emërtim i tillë, emrin e lëndës në tabelat e konventave ndërkombëtare, forma farmaceutike dhe në qoftë se është fjala për një përgatesë, emrin e saj në qoftë se ekziston, sasia e çdo lënde dhe përgatesave, periudha kur do të kryhet eksporti/importi, menyra e transportit ose specicionit, si dhe vendkalimi i kufirit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesës për eksport i bashkëlidhet autorizimi për import e lëshuar nga organet kompetente të vendit importues.

Neni 46

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Autorizimi për import apo eksport përmban të njëjtat të dhëna, si dhe kërkesa për veprimtarinë që autorizohet. Autorizimi import-eksporti përcakton konkretisht nëse veprimi kryhet nëpërmjet një apo më shumë dërgesave.

Autorizimi për eksport përmban gjithashtu edhe numrin dhe datën e autorizimit të importit, i cili vërteton se importimi i lëndëve ose përgatesave është i autorizuar.

Neni 47

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Një kopje autentike e autorizimit për eksport i bashkëlidhet çdo dërgese dhe ministri përgjegjës për Shëndetësinë i adreson një kopje qeverisë së vendit ose territorit importues.

Neni 48

Në qoftë se sasia faktike e bimëve, lëndëve ose përgatesave të importuara është më e

vogël se sasia e shënuar në autorizimin e eksportit, organet doganore dhe të kontrollit të barnave e shënojnë këtë fakt në dokument dhe në të gjitha kopjet zyrtare.

Neni 49

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Kur dërgesa ka hyrë në territorin kombëtar ose kur periudha e caktuar në autorizimin për import mbaron, ministri përgjegjës për Shëndetësinë i dërgon qeverisë së vendit ose territorit eksportues autorizimin për eksport me të dhënat konkrete ku tregohet sasia e çdo bime, lëndë apo përgatesë të importuar në fakt.

Neni 50

Dokumentet tregtare të tilla si faturat, polic-ngarkesat, dokumentet e doganës, të transportit dhe speditimit duhet të përmbajnë emrat e bimëve dhe të lëndëve sipas tabelave të konventave ndërkombëtare, emrat e përgatesave në rast se i kanë, sasitë e eksportuara ose që do të importohen, emrin dhe adresën e eksportuesit, importuesit dhe në, rast se njihet, edhe të marrësit të ngarkesës.

Neni 51

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Eksportimet ose importimet në formën e dërgesave të adresuara për llogari të një personi me emër të ndryshëm nga ai që figuron në autorizimin import-eksporti përkatës janë të ndaluara.

Neni 52

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Eksportimet në formën e një dërgese të adresuar një magazine të doganës janë të ndaluara, përveç rasteve kur qeveria e vendit importues miraton në certifikatën për import një dërgesë të tillë.

Importimet në formën e një dërgese të adresuar një magazinë të doganës janë të ndaluara, përveç rasteve kur ministri përgjegjës për Shëndetësinë ka miratuar në certifikatën e importit një dërgesë të tillë. Çdo tërheqje e mallit nga magazina bëhet me autorizimin import-eksporti të autoriteteve prej të cilëve varet magazina. Çdo dërgesë me destinacion jashtë shtetit konsiderohet eksportim në kuptim të këtij ligji. Lëndët dhe përgatesat e depozituara në magazinën e doganës nuk duhet të pësojnë asnjë lloj trajtimi që do të ndryshonte natyrën e tyre. Ambalazhi i tyre nuk duhet të ndryshojë pa autorizim të autoriteteve prej nga varet magazina.

Neni 53

Dërgesat që hyjnë ose dalin pa qënë të shoqëruara me autorizimin përkatës për import apo eksport, bllokohen nga organet kompetente deri në vërtetimin e legjitimitetit të dërgesës ose daljen e vendimit për konfiskimin e saj.

Neni 54

Pikat doganore, ku lejohet kalimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave që importohen apo eksportohen, përcaktohen nga organet kompetente.

2. KALIMI TRANZIT

Neni 55

Ndalohet kalimi tranzit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë i çdo dërgese të bimëve, lëndëve e përgatesave të tabelës II dhe III, pavarësisht nëse dërgesa është shkarkuar ose jo nga mjeti i saj i transportit. Bëjnë përjashtim rastet kur dërgesa shoqërohet me një kopje autentike të autorizimit për eksport, e cila u paraqitet organeve kompetente.

Neni 56

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Ndalohet ndryshimi i drejtimit të kalimit tranzit të një dërgese në vendin tonë drejt një destinacioni të ndryshëm nga ai që figuron në kopjen e autorizimit për eksport që i bashkëngjitet dërgesës.

Ndryshimi i drejtimit të kalimit tranzit bëhet vetëm me autorizim import-eksporti të organeve përkatëse. Kërkesa për autorizimin import-eksporti të ndryshimit të drejtimit të tranzitimit të dërgesës trajtohet si të ishte një eksportim nga vendi ynë për në vendin e destinacionit të ri.

Neni 57

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Asnjë dërgesë e lëndëve ose përgatesave që kalojnë tranzit në vendin tonë nuk mund të bëhet objekt i çfarëdo trajtimi që do të ndryshonte natyrën e tyre. Ambalazhi i tyre nuk mund të ndryshojë pa autorizimin e posaçëm të organit të caktuar nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë.

Neni 58

Dispozitat e nenit 55, 56 dhe 57 nuk zbatohen në rastet kur dërgesa transportohet me avion, me kusht që avioni të mos ulet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rast se avioni ulet, në varësi nga rrethanat, dërgesa do të trajtohet si eksportim nga vendi ynë drejt vendit të destinacionit dhe do t'i nënshtrohet dispozitave përkatëse.

3. PORTET DHE ZONAT E LIRA

Neni 59

Portet dhe zonat e lira i nënshtrohen të njëjtit kontroll dhe të njëjtës mbikqyrje si gjithë pjesët e tjera të territorit kombëtar.

Ç. TRANSPORTI TREGTAR.

Neni 60

Transportuesit tregtarë duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mjetet e tyre të transportit nuk përdoren për trafikun e paligjshëm të barnave, lëndëve dhe përgatesave të përfshira në këtë ligj.

Personat fizikë e juridikë që merren me transport tregtar duhet :

- të paraqesin në kohën e duhur listën e mallrave që transportohen;

- të mbyllin mallrat në konteniere të vulosur me dyllë të kuq apo plumb, me vula të pafalsifikueshme dhe të dallueshme për kontrollin;
- të informojnë menjëherë organet kompetente për çdo rrethanë të dyshimtë për trafik të paligjshëm.

D. DËRGESAT NË RRUGË POSTARE

Neni 61

Dërgimi në rrugë postare i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përfshira në këtë ligj, lejohet vetëm në formën e pakove postare me vlerë të deklaruar dhe lajmërim- marrje.

KREU VII TREGTIMI DHE SHPËRNDARJA ME PAKICË

A. PËRDORIMI NË KLINIKË PËR NDIHMË URGJENTE DHE MJEKIMIN E TË SËMURËVE.

Neni 62

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Blerjet e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelës II dhe III për dhënien e ndihmës urgjente dhe mjekimin e të sëmurëve bëhet vetëm nga persona fizikë e juridikë privatë të pajisur me autorizim sipas nenit 13, ose ndërmarrje shtetërore të caktuara posaçërisht sipas nenit 15 të këtij ligji.

Neni 63

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Vetëm personat fizikë e juridikë të mëposhtëm lejohen të marrin dhe mbajnë bimë, lëndë dhe përgatesa të tabelave II dhe III për nevoja të ndihmës urgjente profesionale :

- Farmacitë;
- Farmacitë e spitaleve shtetërore ose private dhe të qendrave shëndetësore;
- Depot shtetërore ose private të barnave që janë nën përgjegjësinë e farmacistit dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë;
- Spitalet dhe qendrat shëndetësore pa farmacist përgjegjës, por me një mjek që punon në institucion dhe mban përgjegjësinë për lëndët dhe përgatesat në fjalë;
- Mjekët dhe veterinerët e autorizuar të japin barna sipas një listë të përcaktuar përkatësisht nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për Bujqësinë;
- Mjekët dhe veterinerët për nevoja të shërbimit të urgjencës brenda kufijve cilësorë dhe sasiorë të përcaktuar përkatësisht nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për Bujqësinë;
- Mjekët stomatologë dhe mamitë për nevoja të shërbimit të urgjencës sipas listës së përcaktuar nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë.

B. SHITJA ME PAKICË TË SËMURËVE

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR BIMËT, LËNDËT DHE PËRGATESAT E TABELAVE II DHE III.

Neni 64

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës II mund të përshkruhen dhe t'u jepen të sëmurëve në pajtim me përdorimin e tyre terapeutik dhe vetëm me receta të lëshuar nga një kategori mjekësh, të cilët përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë.

Neni 65

Bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës III mund të përshkruhen dhe t'u jepen të sëmurëve në pajtim me përdorimin e tyre terapeutik dhe vetëm me receta të lëshuar nga :

- Mjeku;
- Mjeku stomatolog për trajtimin e një sëmundjeje dentare;
- Mjeku veteriner për përdorim veterinar.

Neni 66

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Barnat e tabelave II dhe III mund të shiten nga :

- Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike;
- Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike veterinarë sipas listës së përcaktuar nga ministri përgjegjës për Bujqësinë.

Neni 67

Të gjitha recetat për këto barna duhet të përmbajnë :

- Emrin, specialitetin dhe adresën e mjekut përshkrues;
- Emrin e barit, dozën dhe instruksionet për përdorimin e tij;
- Sasinë e përshkruar ose periudhën e trajtimit dhe eventalisht numrin e recetave të përsëritura;
- Emrin, mbiemrin dhe moshën e të sëmurit; në recetën e lëshuar nga veterineri emrin dhe mbiemrin e pronarit të kafshës;
- Datën e lëshimit dhe firmën e vulën e mjekut përshkrues, dhe eventalisht vulën e institucionit.

Ndalohej ekzekutimi i recetave që nuk plotësojnë kërkesat e këtij neni.

Neni 68

Pas ekzekutimit të recetës, ajo vullohet nga farmacisti apo mjeku a veterineri i autorizuar të shesë barna, dhe i vendoset numri rendor i recetave të regjistruara (numri i kuponit) dhe data e dhënies së barit.

Neni 69

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Kushtet dhe kriteret e përshkrimit dhe shitjes së barnave të tabelave II dhe III në spitale dhe qendra shëndetësore përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë.

Neni 70

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Pavarsisht nga dispozitat e nenieve 66, 67 dhe 68, ministri përgjegjës për Shëndetësinë, nëse e kërkon situata dhe në kushtet që ai gjykon, mund të autorizojë në të gjithë vendin ose në një pjesë të tij, farmacistët e pajisur me autorizim të shesin me pakicë, të furnizojnë lirisht dhe pa recetë të sëmurët, për qëllime vetëm mjekësore, sasi të vogla të lëndëve psikotrope të tabelës III dhe të përgatesave që i përmbajnë ato.

2. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR BARNAT E TABELËS II

Neni 71

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Recetat për barnat e tabelës II do të përshkruhen pas vizitës së të sëmurëve në receta të posaçme për këtë qëllim, modeli i të cilave miratohet nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë. Në recetë shënohet edhe me fjalë doza dhe numri, si për specialitetet e gatshme, ashtu edhe për përgatesat magjistrale.

Mjekët do të ruajnë bllokun e kopje recetave për 3 vjet për t'ia paraqitur organeve kompetente, kur kërkohet prej tyre.

Neni 72

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i recetave që nuk plotësojnë kërkesat e nenit 71.

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i një recete që përshkruan barna të tabelës II për një periudhë më të gjatë se 7 ditë.

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i një recete për barna të të njëjtës tabelë, të cilat i sëmuri është duke i përdorur sipas përshkrimit të një recete të mëparshme, përveçse kur mjeku përshkruar e përmend këtë në recetë dhe shpjegon gjendjen e përshkrimit të mëparshëm.

Ndalohen të sëmurët që kanë marrë një recetë për një ose më shumë barna të tabelës II, të marrin recetë të re për barna të të njëjtës tabelë gjatë periudhës së trajtimit të treguar në recetën e parë, pa njoftuar mjekun për recetat e mëparshme. Mjeku duhet të verifikojë në librin e shëndetit recetat e mëparshme që ka përfutur i sëmuri.

Neni 73

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Pavarsisht nga dispozita e paragrafit të dytë të nenit 72, barnat e tabelës II me urdhër të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë mund të përshkruhen për një periudhë më të gjatë se 7 ditë, por jo për më shumë se 60 ditë. Këto barna përfshihen në grupin B të tabelës II.

Neni 74

Në qoftë se prurësi i recetës nuk njihet personalisht nga personi i autorizuar të ekzekutojë recetën, ky i fundit mund të kërkojë të shohë letërnjoftimin.

Ndalohet ekzekutimi i recetave të lëshuara me shumë se 7 ditë përpara paraqitjes së tyre.

Farmacisti duhet t'i sistemojë recetat sipas rendit kronologjik dhe t'i ruajë ato për 3 vjet. Me kërkesën e klientit, farmacisti plotëson një kopje recete, ku shënohen dy vija diagonale dhe fjala "kopje".

Neni 75

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Personat e autorizuar që shesin barnat e tabelës II do t'i dërgojnë çdo tre mujor ministrit

përgjegjës për Shëndetësinë një përmbledhje të recetave të ekzekutuara, duke shënuar për secilën emrin e mjekut përshkrues dhe llojin e sasinë e barnave të shitura.

3. DISPOZITA TË VECANTA PËR BARNAT E TABELËS III

Neni 76

Shitja e një bari të grupit A të tabelës III mund të përsëritet vetëm me rekomandim me shkrim të mjekut përshkrues, ku saktësohen numri i përsëritjeve ose periudhën e trajtimit, dhe vetëm në mbarim të periudhës së përdorimit të barit të përcaktuar nga autori i recetës.

Shitja e barnave të grupit B të tabelës III mund të përsëritet vetëm në mbarim të periudhës së përdorimit të barit, në rast se nuk ka udhëzim tjetër nga autori i recetës.

C. NDIHMA E PARË MEDIKAMENTOZE NË MJETET E TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR

Neni 77

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Ministri përgjegjës për Shëndetësinë mund të autorizojë mjetet e transportit publik të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, që qarkullojnë në linja ndërkombëtare, të mbajnë sasi të vogla të barnave të tabelës II dhe III në sasi të nevojshme për dhënie të ndihmës së parë në rastet e urgjencës. Autorizimi i lëshuar me kërkesën e shfytëzuesit të mjetit të transportit përcakton masat e nevojshme për parandalimin e keqpërdorimit të barnave ose trafikimit të paligjshëm të tyre. Në të përcaktohen gjithashtu edhe kushtet e ruajtjes së barnave, regjistrimi i sasive të përdorura dhe të zëvendësuar periodikisht nga personi përgjegjës.

Përdorimi i këtyre barnave në rastet e urgjencës nuk konsiderohet shkelje e dispozitave të pikës B të këtij kreu.

C. MBAJTJA E BARNAVE TË TABELAVE II DHE III NGA TË SËMURËT NË UDHËTIM

Neni 78

Personat në mjekim, të cilët janë në udhëtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, lejohen të mbajnë për përdorim personal barna që përmbajnë lëndë psikotrope të tabelës II dhe III në sasi që nuk i kalon 7 ditë mjekimi për barnat e tabelës II dhe 30 ditë mjekimi për barnat e tabelës III.

Këta të sëmurë duhet të kenë me vete kopje të recetave mjekësore përkatëse.

D. PËRDORIMI I LËNDËVE PSIKOTROPE PËR KAPJE KAFSHËSH

Neni 79

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Me urdhër të vecantë ministrit përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për Bujqësinë përcaktohen lëndët psikotrope të tabelave II dhe III dhe përgatesat e tyre që mund të përdoren për kapje kafshësh, si dhe kushtet e përdorimit të tyre.

DH. MBAJTJA E BARNAVE TË TABELËS II DHE III

Neni 80

Ndalohet mbajtja për çdo qëllim e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelës II dhe III, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj.

KREU VIII DISPOZITA TË VEÇANTA

A. RAPORTIMI PERIODIK

Neni 81

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Personat fizikë e juridikë, privatë e shtetërorë, që kryejnë veprime që lidhen me bimët, lëndët dhe përgatesat e trajtuara në këtë ligj, i dërgojnë raporte periodike ministrit përgjegjës për Shëndetësinë :

1. Jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori, për sasitë e çdo lënde e përgatese të importuar dhe eksportuar, duke treguar edhe vendin e origjinës dhe të destinacionit gjatë çdo tremujori.

2. Jo më vonë se 15 shkurti i çdo viti për të dhënat e vitit kalendarik paraardhës. Në raport saktësohen :

a. sasitë për çdo lëndë dhe përgatesë të prodhuar ose fabrikuar;

b. sasitë e çdo lënde të përdorur për fabrikim :

- lëndë dhe përgatesa që mbulohen nga ky ligj;

- lëndë dhe përgatesa që nuk mbulohen nga ky ligj.

c. sasitë e çdo lënde dhe përgatesë të konsumuar : të furnizuar për shpërndarje me pakicë, për përdorim mjekësor ose për kërkime shkencore.

ç. sasitë për çdo lëndë dhe përgatesë që janë gjendje më 31 dhjetor të vitit për të cilin raportohet.

Ministri përgjegjës për Shëndetësinë mund të kërkojë gjatë vitit raporte të veçanta.

B. PLOTËSIMI I FLETË-POROSIVE PËR VEPRIMTARINË E PËRDITËSHME PROFESIONALE.

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 82

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Të gjitha porositë për bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës II paraqiten nga blerësi në dy fletë me numër rendor nga një bllok tip i miratuar nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë. Fletët duhet të kenë të shënuar emrin, adresën dhe firmën e blerësit, emrin dhe sasinë e bimës, lëndës dhe përgatesës së porositur dhe datën e porosisë.

Shitësi do të mbajë një nga fletët e porosisë, ndërsa tjetrën ia dorëzon blerësit pas firmosjes dhe vulosjes së saj, duke shënuar njëkohësisht edhe numrin dhe datën e daljes në regjistrin e tij bashkë me sasinë e furnizuar.

Fletë-porositë për bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës III duhet të ketë vetëm emrat dhe sasitë e tyre.

Dokumentet ruhen nga palët e interesuara për 3 vjet, për t'ua paraqitur organeve kompetente sa herë që kërkohen prej tyre.

2. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POROSITË E BËRA NGA PERSONAT PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE PROFESIONALE

Neni 83

Porositë e bëra nga mjekët, stomatologët, veterinerët dhe mamitë për kryerjen e veprimtarisë së përditëshme profesionale do të plotësojnë kushtet e nenit 82.

Porositë e tyre duhet t'u drejtohen një farmacisti që ushtron veprimtarinë në zonën e tyre, dhe vetëm nëse nuk ka të tillë, do t'i drejtohen farmacistit në zonën më të afërt.

C. REGJISTRIMI

1. REGJISTRIMI I VEPRIMEVE QË NUK LIDHEN ME SHITJEN TË TË SËMURËT

Neni 84

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Të gjitha blerjet, transferimet, eksportet ose importet e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të Tabelës II dhe III duhet të regjistrohen në kohën e kryerjes së veprimit në një regjistër të posaçëm me numër rendor dhe të sigluar nga organi i caktuar nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë. Regjistrimi bëhet pa fshirje dhe korrigjime dhe përmban : emrin dhe adresën e blerësit dhe shitësit, emërtimin, përbërjen dhe sasinë e çdo produkti të blerë, transferuar, importuar ose eksportuar, si dhe numrin e regjistrit të hyrjes apo daljes.

Personat juridikë që fabrikojnë, përpunojnë ose ndajnë, dhe përdorin këto lëndë për çfardo qëllimi, duhet të regjistrojnë në kohën e kryerjes së procesit, llojin dhe sasinë e çdo lënde të përdorur dhe çdo produkti të përfutur, si dhe të evidentojnë çdo humbje eventuale që rezultojnë gjatë proceseve të kryera.

Regjistri do të përdoret edhe për të evidentuar rrethanat në të cilat ndodh një humbje e shkaktuar nga zjarri, vjedhja ose çdo ngjarje tjetër. Në çdo rast për humbjet informohen menjëherë organet kompetente.

Regjistrimi bëhet në mënyrë të tillë që në çdo kohë të rezultojë saktë sasia e lëndëve që janë gjendje.

Regjistri ruhet për 10 vjet pas kryerjes së veprimit të fundit, për ta paraqitur kur kërkohet nga organet kompetente.

2. REGJISTRIMI I SHITJES PËR TË SËMURËT

Neni 85

Personat e autorizuar që shesin barnat duhet të kryejnë regjistrimin sipas dispozitave të nenit 84 për çdo blerje dhe transferim të bimëve, lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III.

Neni 86

Çdo shitje e barnave të tabelës II dhe III për të sëmurët do të regjistrohet nga personi i autorizuar për shitje menjëherë dhe pa fshirje e korrigjime në regjistrin e recetave.

Regjistri do të ketë një numër rendor të veçantë për çdo bar të shitur dhe do të

përmbajë :

- emrin, specialitetin dhe adresën e autorit të recetës;
- emrin dhe adresën e të sëmurit, dhe për recetat e lëshuara nga mjeku veteriner, emrin dhe adresën e pronarit të kafshës;
- datën e lëshimit;
- emrin e barit ose formulën e përgatesës;
- sasinë e shitur.

Për barnat ose përgatesat e tabelës II, në regjistër do të shënohet edhe emri, adresa, numri i letërnjoftimit të personit që ka paraqitur recetën, në rast se ky nuk është vetë i sëmuri dhe nuk njihet personalisht nga farmacisti.

Çdo përsëritje e recetës me barna të tabelave II dhe III kërkon një regjistrim të ri.

Neni 87

Personat e autorizuar që shesin barna shënojnë në një regjistër të veçantë çdo humbje të shkaktuar nga zjarri, vjedhja ose çdo ngjarje tjetër, si dhe rrethanat në të cilat ndodh. Në çdo rast për humbjet informohen menjëherë organet kompetente.

Neni 88

Regjistri i recetave dhe regjistri i veçantë ruhen për 10 vjet pas kryerjes së veprimit të fundit, për ta paraqitur kur kërkohet nga organet kompetente.

Ç. KUSHTET E RUAJTJES

Neni 89

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Çdo person fizik a juridik, privat e shtetëror, që mban për qëllime të veprimtarisë së përditëshme profesionale bimë, lëndë, përgatesa ose barna të tabelës II duhet t'i ruajë ato në kushtet e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, me qëllim që të parandalohet vjedhja ose çdo formë tjetër shpërdorimi.

D. INVENTARI DHE BILANCI

Neni 90

Personat e përmendur në nenin 89 detyrohen që të paktën një herë në vit të bëjnë inventarin e bimëve, lëndëve, përgatesave ose barnave të tabelave II dhe III që disponojnë, si dhe bilancin e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 91

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009)

Personat e pajisur me autorizim për kryerje veprimtarie sipas dispozitave të këtij ligji, të cilët shesin ose tjetërsojnë veprimtarinë e tyre, janë të detyruar të bëjnë inventarin e bimëve, lëndëve, përgatesave ose barnave të tabelave II dhe III në prani të personit të cilit i kalojnë veprimtaritë, si dhe bilancin e hyrjeve dhe daljeve. Inventari dhe bilanci firmosen nga të dyja palët.

Neni 92

Çdo diferencë e konstatuar në bilanc ose midis bilancit dhe inventarit do t'i njoftohet menjëherë inspektorit të farmacive, i cili verifikon nëse diferenca është rezultat i vjedhjes, shpërdorimit apo ndonjë veprimi tjetër të paligjshëm.

DH. AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Neni 93

Lëndët dhe përgatesat e tabelës II dhe III qarkullojnë të mbyllura në paketa ose ambalazh tjetër të përshtatshëm, me emërtimin të shënuar sipër, dhe në rastin e spedicioninimit të lëndëve të tabelës II, shënohet edhe një shirit i kuq i dyfishtë.

Ndalohet qarkullimi i lëndëve që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme të ambalazhimit.

Ambalazhimi i jashtëm i pakove që dërgohen nuk duhet të ketë sipër asnjë informacion tjetër përveç emrit dhe adresës së dërguesit dhe marrësit, si dhe vulën e dërguesit.

Neni 94

Etiketa me të cilën bari ofrohet për shitje do të ketë emrin e lëndëve të tabelës II dhe II që e përbëjnë, bashkë me përmbajtjen në njësi peshë ose përqindje.

Etiketat dhe fletë-shoqërueset e pakove për shitje me pakicë do të kenë indikimet e përdorimit, si dhe paralajmërimet e nevojshme për të mbrojtur përdoruesin.

Neni 95

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Kërkesat e hollësishme për ambalazhimin dhe etiketimin e lëndëve të tabelës II dhe III përcaktohen në urdhrin e posaçëm të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë.

E. REKLAMA.

Neni 96

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Ndalohet çdo reklamë e lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III që i drejtohet publikut të gjerë.

Ndalohet furnizimi i mjekëve me kampionë të lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II, si dhe shitja të sëmurëve e kampioneve të lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III.

Rregullorja për reklamën e këtyre lëndëve miratohet nga ministri përgjegjës për Shëndetësinë.

KREU IX

KËRKIMET MJEKËSORE, SHKENCORE DHE MËSIMDHËNIA

Neni 97

(ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Për nevoja të kërkimeve shkencore, mjekësore e të mësimdhënies, ministri përgjegjës për Shëndetësinë mund të autorizojë një person fizik të kultivojë, prodhojë, fabrikojë, blejë,

importojë, përdorë dhe mbajë bimë, lëndë dhe përgatesa të tabelave I, II dhe III në sasi të minimale të domosdoshme për këto nevoja.

Personi i autorizuar shënon në një regjistër që ruhet për 10 vjet nga regjistrimi i fundit, sasi të bimëve, lëndëve dhe përgatesave që kultivon, importon, blen, fabrikon, përdor dhe shkatërron. Në regjistër shënohen datat e operacioneve dhe emrat e furnizuesve. ministrit përgjegjës për Shëndetësinë i dërgohet një raport vjetor për operacionet e kryera dhe lëndët që janë gjendje.

KREU X INSPEKTIMI DHE KONSTATIMI I SHKELJEVE

Neni 98

(Ndryshuar paragrafi i dytë me Ligjin nr. 46/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar togfjalësh me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Të gjithë personat fizikë e juridikë, privatë e shtetërorë, të cilët merren me veprimtari që lidhet me bimët, lëndët, përgatesat dhe barnat që përfshin ky ligj, do të kontrollohen e mbikqyren nga organet e autorizuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB), si dhe organet e tjera të autorizuar bëjnë, të paktën një herë në dy vjet, inspektimin e programuar të objekteve, ndërtesave, lëndëve gjendje dhe regjistrave. Inspektimet jashtë programit kryhen në çdo kohë. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Ky kontroll shtrihet edhe në mjediset ku ndodhen pajisjet e ndihmës së parë në mjetet e transportit publik të linjave ndërkombëtare.

Neni 99

(ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 10 137/2009, datë 11.5.2009; ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 46/2013, datë 14.2.2013)

Inspektorët e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave (QKKB) lejohet të hyjnë, të marrin kampione dhe të bllokojnë veprimtaritë ose lëndët, në çdo rast, kur konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Kontrolli në ndërtesat private, vecanërisht kur u përkasin personave pa autorizim, në rastin kur dyshohet për kryerjen e veprimtarive të paligjshme, bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të këtyre personave ose në përputhje me dispozitat në fuqi.

Inspektorët e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave (QKKB) duhet të bëjnë kallëzim në organet kompetente të hetimit kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji që përbëjnë vepër penale.

Neni 100

Personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari të parashikuara në këtë ligj duhet të bashkëpunojnë me organet e kontrollit dhe t’u krijojnë lehtësitë e nevojshme për kryerjen e inspektimeve dhe të kontrollit të dokumentacionit.

KREU XI KUNDRAVJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 101

(shtuar paragraf me Ligjin nr. 46/2013, datë 14.2.2013)

Kur shkelja e dispozitave të parashikuara në neniet 13-18, 22-26, 30-38, 41-44, 47, 50-52, 55-57, 61-68, 71-72, 74-94, 96-99 të këtij ligji nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 10.000 deri 100.000 lekë. Në rast përsëritjeje gjoba është nga 20.000 deri 200.000.

Pengimi i inspektorëve të farmacive në kryerjen e detyrës dënohet me gjobë deri 50 000 lekë.

Masa e gjobës është dënim kryesor.

Neni 102

(ndryshuar me Ligjin nr. 46/2013, datë 14.2.2013)

1. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Kundër vendimit të organeve të tjera që nuk gëzojnë statusin e inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

3. Ekzekutimi i vendimeve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU XII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 103

(ndryshuar me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Skema e klasifikimit dhe tabelat e barnave narkotike, lëndëve psikotrope dhe përgatesave të tyre janë sipas skemës dhe tabelave I, II dhe III, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 104

Të gjitha dispozitat që bijen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozitë kalimtare

(e ligjit nr. 46/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 105

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1184, datë 8.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

SKEMA E KLASIFIKIMIT TË BARNAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

BARNË NARKOTIKE DHE LËNDË PSIKOTROPE			
Lëndë shumë të rrezikshme		Lëndë të rrezikshme	
Tabela I	Tabela II	Tabela III	
Lëndë që nuk përdoren në mjekësi	Lëndë që përdoren në mjekësi		
(1)Barna narkotike të listës IV të Konventës për Narkotikët, 1961 dhe lëndët psikotrope të Listës I të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971. (2) Eventualisht lëndë të Listave të tjera të Konventave të lartpërmendura (3) Eventualisht lëndë të tjera	(1)Barna narkotikë të Listës I' dhe II të Konventës për Narkotikët, 1961. (2)Lëndë psikotrope të Listës II të Konventës për Lëndët Psikotrope,1971 (3)Eventualisht lëndë të listave të tjera të Konventave të lartpërmendura, me përjashtim të lëndëve që përfshihen në tabelën I (shih majtas) (4)Eventualisht lëndë të tjera Grupi A: Lëndë dhe barna që mund të përshkruhen për jo më shumë se 7 ditë. Grupi B: Lëndë dhe barna që mund të përshkruhen për jo më shumë se 60 ditë	(1)Përgatesat e Listës III të Konventës për Narkotikët, 1961. (2)Lëndët psikotrope të Listës III dhe IV të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971. (3) Eventualisht lëndë të tjera Grupi A: Lëndë dhe barna për të cilat ndalohet ripërsëritja e recetës pa autorizim me shkrim të përshkruesit të recetës. Grupi B: Lëndë dhe barna për të cilat lejohet ripërsëritja e recetës, me përjashtim të rasisit kur përshkruesi i recetës mendon ndryshe.	
Kontrolli i rreptë i trafikut të paligjshëm		Kontrolli i trafikut të paligjshëm	
Ndihet penalisht mbajtja për konsum veçjak			

1) Me përjashtim të lëndëve të Listës IV.

KLASIFIKIMI I BARNAVE NARKOTIKË DHE LËNDËVE PSIKOTROPE*

(Ndryshuar tabela I, lista IV ; tabela I, lista I; tabela II, lista II; tabela III, lista III; tabela III, lista IV , tabela III, lista V dhe paragrafët *) dhe **) me Ligjin nr. 99/2023, datë 14.12.2023)

Tabela I - Lista IV (Konventa e 1961)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
ACETORPHINE	3-O-acetyl-tetrahydro-7 α -(1-hydroxy-1-methylbutyl)-6,14-endo-ethenooripavine (derivative of thebaine)
ACETYL-ALPHA-METHYLFENTANYL	N-[1-(α -methylphenethyl)-4-piperidyl]acetanilide
ACETYLFENTANYL	N-Phenyl-N-[1-(2-phenylethyl)-4-piperidinyl]acetamide
ALPHA-METHYLFENTANYL	N-[1-(α -methylphenethyl)-4-piperidyl]propionanilide
ALPHA-METHYLTHIOFENTANYL	N-[1-[1-methyl-2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide
BETA-HYDROXYFENTANYL	N-[1-(β -hydroxyphenethyl)-4-piperidyl]propionanilide
BETA-HYDROXY-3-METHYLFENTANYL	N-[1-(β -hydroxyphenethyl)-3-methyl-4-piperidyl]propionanilide
CANNABIS	the flowering or fruiting tops of the cannabis plant (resin not extracted)
CANNABIS RESIN, EXTRACTS and TINCTURES	the separated resin, crude or purified, obtained from the cannabis plant
CARFENTANIL	Methyl 1-(2-phenylethyl)-4-[phenyl(propionyl)amino]piperidine-4-carboxylate
DESOMORPHINE	Dihydrodesoxymorphine (derivative of morphine)
ETORPHINE	tetrahydro-7 α -(1-hydroxy-1-methylbutyl)-6,14-endo-ethenooripavine (derivative of thebaine)
HEROIN	diacetylmorphine (derivative of morphine)
KETOBEMIDONE	4-m-hydroxyphenyl-1-methyl-4-propionylpiperidine
3-METHYLFENTANYL	N-(3-methyl-1-phenethyl-4-piperidyl)propionanilide
3-METHYLTHIOFENTANYL	N-[3-methyl-1-[2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide
MPPP	1-methyl-4-phenyl-4-piperidinol propionate (ester)
para-FLUOROFENTANYL	4'-fluoro-N-(1-phenethyl-4-piperidyl)propionanilide
PEPAP	1-phenethyl-4-phenyl-4-piperidinol acetate (ester)
THIOFENTANYL	N-[1-[2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide

Tabela I - Lista I (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
CATHINONE	(-)-(S)-2-aminopropiophenone
DET	3-[2-(diethylamino)ethyl]indole
DMHP	3-(1,2-dimethylheptyl)-7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-6H-dibenzo[b,d]pyran-1-ol
DMT	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indole
DMA	($\pm$)-2,5-dimethoxy- α -methylphenethylamine
DOET	($\pm$)-4-ethyl-2,5-dimethoxy- α -methylphenethylamine
BROLAMFETAMINE, DOB	($\pm$)-4-bromo-2,5-dimethoxy- α -methylphenethylamine
DOC	4-Chloro-2,5-dimethoxyamfetamine
ETRYPTAMINE	3-(2-aminobutyl)indole
(+)-LYSERGIDE, LSD, LSD-25	9,10-didehydro-N,N-diethyl-6-methylergoline-8 β -carboxamide
mescaline	3,4,5-trimethoxyphenethylamine
MDMA	($\pm$)-N, α -dimethyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
MMDA	5-methoxy- α -methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
TENAMFETAMINE, MDA	α -methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
4-methylaminorex	($\pm$)- <i>cis</i> -2-amino-4-methyl-5-phenyl-2-oxazoline
methcathinone	2-(methylamino)-1-phenylpropan-1-one
4-MTA	α -methyl-4-methylthiophenethylamine
N-ethyl MDA, MDEA	($\pm$)-N-ethyl- α -methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
N-hydroxy MDA	($\pm$)-N[α -methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethyl]hydroxylamine
25B-NBOMe	2-(4-bromo-2,5-dimethoxyphenyl)-N-(2-methoxybenzyl)ethanamine
25C-NBOMe	2-(4-chloro-2,5-dimethoxyphenyl)-N-(2-methoxybenzyl)ethanamine
25I-NBOMe	2-(4-iodo-2,5-dimethoxyphenyl)-N-(2-methoxybenzyl)ethanamine
parahexyl	3-hexyl-7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-6H-dibenzo[b,d]pyran-1-ol
ETICYCLIDINE, PCE	N-ethyl-1-phenylcyclohexylamine
ROLICYCLIDINE, PHP, PCPY	1-(1-phenylcyclohexyl)pyrrolidine
psilocine, psilocin	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indol-4-ol
PSILOCYBINE	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indol-4-yl dihydrogen phosphate
PMA	1-(4-methoxyphenyl)propan-2-amine

PMMA	1-(4-methoxyphenyl)-2-methylaminopropane
STP, DOM	2,5-dimethoxy- α ,4-dimethylphenethylamine
TENOCYLIDINE, TCP	1-[1-(2-thienyl)cyclohexyl]piperidine
TETRAHYDRO- CANNABINOL, THC	tetrahydrocannabinol, the following isomers and their stereochemical variants:
delta-6a(10a)-THC	7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H-dibenzo[b,d]pyran-1-ol
delta-6a(7)-THC	(9R,10aR)-8,9,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H- dibenzo[b,d]pyran-1-ol
delta-7-THC	(6aR,9R,10aR)-6a,9,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H- dibenzo[b,d]pyran-1-ol
delta-8-THC	(6aR,10aR)-6a,7,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H- dibenzo[b,d]pyran-1-ol
delta-10-THC	6a,7,8,9-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H-dibenzo[b,d]pyran-1-ol
delta-9(11)-THC	(6aR,10aR)-6a,7,8,9,10,10a-hexahydro-6,6-dimethyl-9-methylene-3-pentyl-6H-dibenzo [b,d]pyran-1 -ol
TMA	($\pm$)-3,4,5-trimethoxy- α -methylphenethylamine

TABELA II
LISTA I (KONVENTA E 1961)

Acetilmetadol
 Alfacetilmetadol
 Alfameprodinë
 Alfametadol
 Alfaprodinë
 Alfentanil
 Alilprodinë
 Anileridinë
 Benzetidinë
 Benzilmorfinë
 Betacetilmetadol
 Betameprodinë
 Betametadol
 Betaprodinë
 Bezitramid
 Butirat i dioksafetilit
 Dekstromoramid
 Diampromid
 Dietiltiambuten
 Difenoksilat
 Difenoksinë
 Dihidromorfinë
 Dimenoksadol
 Dimepheptanol
 Dimetiltaiambuten
 Dipipanon
 Drotebanol
 Ekgoninë, esteret dhe derivatet e saj
 Etilmetiltiambuten
 Etokseridinë
 Etonitazen
 Fenodokson
 Fenampromid
 Fenazocinë
 Fenamorfani
 Fenoperidinë
 Fentanil
 Furetidinë

Gjethe e kokës
Hidrokodon
Hidroksipetidinë
Hidromorfinol
Hidromorfon
Izometadon
Klonitazen
Kodoksimë
Kokainë
Koncentrat i kashtës së hashashit
Levofenacilmorfan
Levometorfan
Lavomoramid
Lavorfanol
Metadon
Metazocinë
Metildezorfinë
Metildihidromorfinë
Metobromid i morfinës dhe derivate të tjerë të morfinës të azotit 5 valentë
Metopon
Mirofinë
Morferidinë
Morfinë***
Morfinë - N - oksid
Nikomorfinë
Noracimetadol
Norlevorfanol
Normetadon
Normorfinë
Norpipanon
Oksikodon
Oksimorfon
Opium
Petidinë
Produkt ndërmjetës A i petidinës (4-cian-1-metil-4-fenilpiperdinë)
Produkt ndërmjetës B i petidinës (esteri etilik i acidit 4-fenilpiperidinë-4-karboksilik).
Produkt ndërmjetës C i petidinës (acid 1-metil-4-fenilpiperidinë-4-karboksilik)
Produkt ndërmjetës i metadonit (4-cian-2-dimetilamino-4,4-difenilbutan)
Produkt ndërmjetës i moramidit (acid 2-metil-3-morfolino-1,1-difenilpropan karboksilik)
Piminodinë
Piritramid
Proheptazinë
Properidinë
Racemeterfan
Racemoramid
Racemorfan
Sufentanil
Tebainë
Tebakon
Tilidinë
Trimeperdinë

Tabela II - Lista II (Konventa e 1961)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
ACETYLDIHYDROCODEINE	(derivative of codeine)
CODEINE	3-methylmorphine (derivate of morphine, alkaloid contained in opium and poppy straw)
DEXTROPROPOXYPHENE	α -(+)-4-dimethylamino-1,2-diphenyl-3-methyl-2-butanol propionate (Dextro-rotary isomer of propoxyphene)
DIHYDROCODEINE	(derivative of morphine)
ETHYLMORPHINE	3-ethylmorphine (derivative of morphine)
NICOCODINE	6-nicotinylcodeine (derivative of morphine)
NICODICODINE	6-nicotinyldihydrocodeine (derivative of morphine)
NORCODEINE	N-demethylcodeine (derivative of morphine)
PHOLCODINE	morpholinylethylmorphine (derivative of morphine)
PROPIRAM	N-(1-methyl-2-piperidinoethyl)-N-2-pyridylpropionamide

Tabela II - Lista II (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
AMFETAMINE, amphetamine	($\pm$)- α -methylphenethylamine
AMINEPTINE	7-[(10,11-dihydro-5H-dibenzo [a,d]cyclohepten-5-yl)amino]heptanoic acid
AM-2201, JWH-2201	[1-(5-Fluoropentyl)-1H-indol-3-yl](naphthalen-1-yl)methanone
5F-APINACA, 5F-AKB-48	N-(adamantan-1-yl)-1-(5-fluoropentyl)-1H-indazole-3-carboxamide
5F-AMB, 5F-AMB-PINACA	Methyl 2-({[1-(5-fluoropentyl)-1H-indazol-3-yl]carbonyl}amino)-3-methylbutanoate
2C-B	4-bromo-2,5-dimethoxyphenethylamine
AB-CHMINACA	N-[(2S)-1-amino-3-methyl-oxobutan-2-yl]-1-(cyclohexylmethyl)-1H-indazole-3-carboxamide
CUMYL-4CN- BINACA	1-(4-cyanobutyl)-N-(2-phenylpropan-2-yl)-1H-indazole-3-carboxamide
ADB- CHMINACA, MAB-CHMINACA	N-[(2S)-1-amino-3,3-dimethyl-1-oxobutan-2-yl]-1-(cyclohexylmethyl)-1H-indazole-3-carboxamide
4-CMC (4-chloromethcathinone), clephedrone	1-(4-chlorophenyl)-2-(methylamino)-1-propanone
CUMYL- PEGACLONE	5-Pentyl-2-(2-phenylpropan-2-yl)-2,5-dihydro-1H-pyrido [4,3-b]indol-1-one
DEXAMFETAMINE, dexamphetamine	(+)- α -methylphenethylamine
DRONABINOL, <i>delta</i> -9-tetrahydrocannabinol and its stereochemical variants	(6aR,10aR)-6a,7,8,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H-dibenzo[b,d]pyran-1-ol
diphenidine	1-(1,2-Diphenylethyl)piperidine
ethylone	(RS)-1-(1,3-Benzodioxol-5-yl)-2-(ethylamino)propan-1-one
ethylphenidate	ethyl 2-phenyl-2-piperidin-2-ylacetate [1]
Eutylone	
FENETYLLINE	7-[2-[(a-methylphenethyl)amino]ethyl]theophylline
4-fluoroamphetamine, 4-FA	1-(4-Fluorophenyl)propan-2-amine
FUB-AMB, MMB- FUBINACA, AMB- FUBINACA	Methyl(2S)-2-({[1-[4-fluorophenyl]methyl-1H-indazole-3-carbonyl}amino)-3-methylbutanoate
ADB-FUBINACA	N-[(2S)-1-amino-3,3-dimethyl-1-oxobutan-2-yl]-1-[(4-fluorophenyl)methyl]-1H-indazole-3-carboxamide
AB-FUBINACA	N-[(2S)-1-amino-3-methyl-1-oxobutan-2-yl]-1-[(4-fluorophenyl)methyl]indazole-3-carboxamide
gamma- HYDROXYBUTIRIC ACID, GHB	γ -hydroxybutyric acid
JWH-018, AM-678	Naphthalene-1-yl(1-pentyl-1H-indol-3-yl)methanone
LEVAMFETAMINE, levamphetamine	(-)-(R)- α -methylphenethylamine
LEVMEFAMFETAMINE, levomethamphetamine	(-)-N, α -dimethylphenethylamine
MECLOQUALONE	3-(o-chlorophenyl)-2-methyl-4(3H)-quinazolinone
METAMFETAMINE, methamphetamine	(+)-(S)-N, α -dimethylphenethylamine
METHAQUALONE	2-methyl-3-o-tolyl-4(3H)-quinazolinone
METHYLPHENIDATE	methyl α -phenyl-2-piperidine acetate
METAMFETAMINE RACEMATE, methamphetamine racemate	($\pm$)-N, α -dimethylphenethylamine
MDPV, 3,4-methylenedioxypropylvalerone	(RS)-1-(Benzo[d][1,3]dioxol-5-yl)-2-(pyrrolidin-1-yl)pentan-1-one
mephedrone, 4-methylmethcathinone	(RS)-2-methylamino-1-(4-methylphenyl)propan-1-one
methylone, <i>beta</i> -keto-MDMA	(RS)-2-methylamino-1-(3,4-methylenedioxyphenyl)propan-1-one

methoxetamine, MXE	(RS)-2-(3-methoxyphenyl)-2-(ethylamino)- cyclohexanone
MDMB-CHMICA	methyl 2-[[1-(cyclohexylmethyl)indole-3- carbonyl]amino]-3,3dimethylbutanoate
methiopropamine, MPA	1-(thiophen-2-yl)-2-methylaminopropane
4-methylethcathinone, 4-MEC	2-(Ethylamino)-1 -(4-methylphenyl)propan-1 -one
5F-MDMB-PICA	Methyl(S)-2-(1-(5-fluoropentyl)-1H-indole-3- carboxamido)-3,3-dimethylbutanoate
4F-MDMB- BINACA	Methyl(S)-2-(1-(4-fluorobutyl)-1H-indazole-3- carboxamido)-3,3-dimethylbutanoate
MDMB-4en- PINACA	Methyl 3,3-dimethyl-2-(1- (pent-4-en-1-yl)-1H-indazole-3- carboxamido)butanoate
3-Methoxyphencyclidine	1-(1-(3-Methoxyphenyl)cyclohexyl)piperidine
N-benzylpiperazine, benzylpiperazine, BZP	1 -benzylpiperazine
N-ethylnorpentylone	1 -(2H- 1,3-benzodioxol-5-yl)-2-(ethylamino)pentan-1 -one
N-ethylhexedrone	2-(Ethylamino)-1 -phenyl-1 -hexanone
PHENCYCLIDINE, PCP	1-(1 -phenylcyclohexyl)piperidine
PHENMETRAZINE	3-methyl-2-phenylmorpholine
5F-ADB, 5F-MDMB-PINACA	Methyl(2S)-2- {[1 -(fluoropentyl)-1H-indazole-3-carbonyl]amino} -3,3-dimethylbutanoate
AB-PINACA	N-[(2S)-1 -Amino-3-methyl-1 -oxobutan-2-yl] -1- pentyl-1H-indazole-3-carboxamide
<i>alpha</i> -PVP	α -pyrrolidinovaleerophenone
para-Methyl-4- methylaminorex, 4,4'-DMAR	4-Methyl-5-(4-methylphenyl)-4,5-dihydro-1,3-oxazol-2- amine
pentedrone	($\pm$)-2-(methylamino)-1 -phenylpentan-1 -one
5F-PB-22	Quinolin-8-yl 1-(5-fluoropentyl)-1H-indole-3-carboxylate
<i>alpha</i> -PHP	(RS)-1 -Phenyl-2-(pyrrolidine-1 -yl)hexan-1 -one
SECOBARBITAL	5-allyl-5-(1 -methylbutyl)barbituric acid
UR-144	(1-Pentyl-1H-indol-3-yl)(2,2,3,3- tetramethylcyclopropyl)methanone
XLR-11	[1 -(5-Fluoropentyl)- 1H-indol-3- yl](2,2,3,3tetramethylcyclopropyl)methanone
ZIPEPROL	α -(α -methoxybenzyl)-4-(β -methoxyphenethyl)-1-piperazineethanol
ADB-BUTINACA	N-[1-(Aminocarbonyl)-2,2-dimethylpropyl]-1-butyl-1H-indazole-3-carboxamide
α -PiHP	4-methyl-1-phenyl-2-(pyrrolidin-1-yl)pentan-1-one
3-Methylmethcathinone	2-(Methylamino)-1-(3-methylphenyl)propan-1-one
GBL	Gamma-butyrolactone; γ -butyrolactone
Ketamine	Ketamine

TABELA III - LISTA III (KONVENTA E 1961)

1. Përgatesat e acetildihidrokodeinës, dihidrokodeinës, etilmorfinës, folkodinës, kodeinës, nikodikodinës, nikokodinës dhe norkodeinës kur kombinoohen me një ose më shumë ingredient të tjerë dhe që përmbajnë jo më shumë se 100 mg të barit narkotik për dozë, si dhe përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind.

2. Përgatesat e propiramat që përmbajnë jo më shumë se 100 mg propiram për dozë dhe të kombinuara të paktën me të njëjtën sasi metilceluloze.

3. Përgatesat e dekstropropoksifenit për përdorim nga goja që përmbajnë jo më shumë se 135mg dekstropropoksifen bazë për dozë ose përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind, me kusht që këto përgatesa të mos përmbajnë ndonjë lëndë që janë në kontroll sipas Konventës për lëndët psikotrope të vitit 1971.

4. Përgatesat e kokainës që përmbajnë jo më shumë se 0,1 për qind kokainë e llogaritur si kokainë bazë dhe përgatesat e opiumit ose të morfinës që përmbajnë jo më shumë se 0,2 për qind morfinë e llogaritur si morfinë bazë pa ujë, si dhe të kombinuara me një ose më shumë ingredientë të tjerë në një mënyrë të tillë që bari narkotik nuk mund të rimerret lehtësisht dhe në sasi që të rrezikojë shëndetin e popullatës.

5. Përgatesat e difenoksinës që përmbajnë jo më shumë se 0,5 mg difenoksinë për dozë dhe një sasi sulfat atropine të paktën 5 për qind të dozës së difenoksinës.

6. Përgatesat e difenoksilatit që përmbajnë jo më shumë se 2.5 mg difenoksilat për dozë, llogaritur si bazë dhe një sasi sulfat atropine ekuivalente me të paktën 1 për qind të dozës së difenoksilatit.

7. Pulvis ipecacuanhae et opii compositus:

Pluhur opiumi 10 për qind;

Pluhur i rrënjës së ipekes 10 për qind i përzierë me 80 për qind pluhur plotësues që nuk përmban ndonjë bar narkotik.

8. Përgatesat e lartpërmendura dhe të kombinuara me përgatesa të tjera që nuk përmbajnë barna narkotike.

Tabela III - Lista III (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
AMOBARBITAL	5-ethyl-5-isopentylbarbituric acid
BUTALBITAL	5-allyl-5-isobutylbarbituric acid
BUPRENORPHINE	2l-cyclopropyl-7- α -[(S)-1-hydroxy-1,2,2- trimethylpropyl] -6,14-endo-ethano-6,7,8,14-tetrahydrooripavine

CYCLOBARBITAL	5-(1-cyclohexen-1-yl)-5-ethylbarbituric acid
CATHINE, (+)- norpseudoephedrine	(+)-(S)- α -(S)-1-aminoethyl]benzyl alcohol
FLUNITRAZEPAM	5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
GLUTETHIMIDE	2-ethyl-2-phenylglutarimide
PENTOBARBITAL	5-ethyl-5-(1-methylbutyl)barbituric acid
PENTAZOCINE	(2R*,6R*,11R*)-1,2,3,4,5,6-hexahydro-6,11-dimethyl-3-(3-methyl-2-butenyl)-2,6-methano-3-benzazocin-8-ol

Tabela III - Lista IV (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
AMFEPRAMONE, diethylpropion	2-(diethylamino)propiophenone
ALPRAZOLAM	8-chloro-1-methyl-6-phenyl-4H-s-triazolo[4,3-a][1,4]benzodiazepine
ALLOBARBITAL	5,5-diallylbarbituric acid
AMINOREX	2-amino-5-phenyl-2-oxazoline
BARBITAL	5,5-diethylbarbituric acid
BENZFETAMINE, benzphetamine	N-benzyl-N, α -dimethylphenethylamine
BROMAZEPAM	7-bromo-1,3-dihydro-5-(2-pyridyl)-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
BUTOBARBITAL	5-butyl-5-ethylbarbituric acid
BROTTZOLAM	2-bromo-4-(o-chlorophenyl)-9-methyl-6H-thieno[3,2- f]-s-triazolo[4,3-a][1,4]diazepine
CAMAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one dimethylcarbamate (ester)
CHLORDIAZEPOXIDE	7-chloro-2-(methylamino)-5-phenyl-3H-1,4- benzodiazepine-4-oxide
CLOBAZAM	7-chloro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,5-benzodiazepine- 2,4(3H,5H)-dione
CLONAZEPAM	5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-7-nitro-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
CLORAZEPATE	7-chloro-2,3-dihydro-2-oxo-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylic acid
CLOTIAZEPAM	5-(o-chlorophenyl)-7-ethyl-1,3-dihydro-1-methyl-2H-thieno[2,3-e]-1,4-diazepin-2-one
CLOXAZOLAM	10-chloro-11b-(o-chlorophenyl)-2,3,7,11b-tetrahydro-oxazolo- [3,2-d][1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
CLONAZOLAM	6-(2-Chlorophenyl)-1 -methyl-8-nitro-4H- benzo [f][1,2,4]triazolo [4,3-a][1,4]diazepine
DELORAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
DIAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-1 -methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
DICLAZEPAM	7-Chloro-5-(2-chlorophenyl)-1-methyl-1,3-dihydro-2H-benzo [d][1,4]diazepin-2-one
ETHCHLORVYNOL	1 -chloro-3-ethyl-1-penten-4-yn-3-ol
ETHINAMATE	1 -ethynylcyclohexanolicarbamate
ESTAZOLAM	8-chloro-6-phenyl-4H-s-triazolo[4,3- a][1,4]benzodiazepine
ETHYL LOFLAZEPATE	ethyl 7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-2,3-dihydro-2-oxo-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylate
ETILAMFETAMINE, N-ethylamphetamine	N-ethyl- α -methylphenethylamine
ETIZOLAM	4-(2-Chlorophenyl)-2-ethyl-9-methyl-6H-thieno [3,2-f][1,2,4]triazolo[4,3a][1,4]diazepine
FLUDIAZEPAM	7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
FLURAZEPAM	7-chloro-1-[2-(diethylamino)ethyl]-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
FENCAMFAMIN	N-ethyl-3-phenyl-2-norbornanamine
FENPROPorex	($\pm$)-3-[(α -methylphenylethyl)amino]propionitrile
FLUALPRAZOLAM	8-Chloro-6-(2-fluoro-phenyl)-1 -methyl-4h- benzo [f][1,2,4]triazolo [4,3-a][1,4]diazepine
FLUBROMAZOLAM	8-Bromo-6-(2-fluorophenyl)-1 -methyl-4H-benzo[f] [1,2,4]triazolo [4,3-a][1,4]diazepine
HALAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2,2,2-trifluoroethyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
HALOXAZOLAM	10-bromo-11b-(o-fluorophenyl)-2,3,7,11b- tetrahydrooxazolo[3,2-d] [1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
KETAZOLAM	11 -chloro-8,12b-dihydro-2,8-dimethyl-12b-phenyl-4H-[1,3]oxazino[3,2-d][1,4]benzodiazepin-4,7(6H)-dione
LEFETAMINE, SPA	(-)-N,N-dimethyl-1,2-diphenylethylamine
LOPRAZOLAM	6-(o-chlorophenyl)-2,4-dihydro-2-[(4-methyl-1- piperazinyl)methylene]-8-nitro-1H-imidazo[1,2-a][1,4]benzodiazepin-1-one
LORAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
LORMETAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
MAZINDOL	5-(p-chlorophenyl)-2,5-dihydro-3H-imidazo[2,1-a]isoindol-5-ol
MEPROBAMATE	2-methyl-2-propyl-1,3-propanedioldicarbamate
METHYLPHENOBARBITAL	5-ethyl-1-methyl-5-phenylbarbituric acid
METHYPRYLON	3,3 -diethyl-5-methyl-2,4-piperidine-dione
MEDAZEPAM	7-chloro-2,3-dihydro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine
MEFENOREX	N-(3-chloropropyl)- α -methylphenethylamine
MIDAZOLAM	8-chloro-6-(o-fluorophenyl)-1 -methyl-4H-imidazo[1,5-a][1,4]benzodiazepine
MESOCARB	3-(α -methylphenethyl)-N-(phenylcarbamoyl)sydnone imine
NIMETAZEPAM	1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
NITRAZEPAM	1,3-dihydro-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
NORDAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
OXAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
OXAZOLAM	10-chloro-2,3,7,11b-tetrahydro-2-methyl-11b-phenyloxazolo[3,2-d][1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
PHENDIMETRAZINE	(+)-(2S,3S)-3,4-dimethyl-2-phenylmorpholine
PHENOBARBITAL	5-ethyl-5-phenylbarbituric acid
PHENTERMINE	α,α -dimethylphenethylamine
PIPRADROL	1,1 -diphenyl-1 -(2-piperidyl)methanol
PINAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2-propynyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
PRAZEPAM	7-chloro-1-(cyclopropylmethyl)-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
PYROVALERONE	4'- methyl-2-(1 -pyrrolidinyl)valerophenone
PEMOLINE	2-amino-5-phenyl-2-oxazolin-4-one
PHENAZEPAM, FENAZEPAM	7-bromo-5-(2-chlorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
SECUTABARBITAL	5-sec-butyl-5-ethylbarbituric acid
TEMAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
TETRAZEPAM	7-chloro-5-(1 -cyclohexen-1-yl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
TRIAZOLAM	8-chloro-6-(o-chlorophenyl)-1 -methyl-4H-s-triazolo[4,3- a][1,4] benzodiazepine
VINYLBITAL	5-(1-methylbutyl)-5-vinylbarbituric acid
ZOLPIDEM	N,N,6-trimethyl-2-p-tolylimidazo[1,2-a]pyridine-3-acetamide

Tabela III (lista V)	
LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
Nitrous oxide; N ₂ O	Oxodiazén-2-ium-1-ide

*) Renditja e barnave narkotikë, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të tjera në tri tabela dhe nëntë lista është bërë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe Konventës për Barnat Narkotike të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971, të rishikuara, dhe që janë në fuqi që prej 1 korrikut 1993.

****) Këtij ligji i nënshtrohen edhe izomerët, esteret, eteret, kriprat dhe prëgatesat e lëndëve që përfshihen në të gjitha listat e mësipërme veç rasteve kur ato përjashtohen nga masat e kontrollit.